



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**  
*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit*  
*Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije*  
*Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*



**INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS**

## **RAPORTI I KOMISIONIT PROFESIONAL-SHKENCOR PËR ZBATIMIN E PROCEDURËS SË ZGJEDHJES SË HULUMTUESIT TË PAVARUR PËR UDHËHEQJE DHE MENAXHIM NË ARSIM NË INSTITUTIN PEDAGOGJIK TË KOSOVËS**

Në bazë të Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, nr. 04/L-135, të datës 11/02 maj 2013, nenit 48 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, dhe Rregullores nr. 55/24 të datës 12.09.2024 për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencorë dhe Hulumtuesve në IPK, Këshilli Drejtues i IPK-së ka shpallur konkursin për zgjedhjen e e dy hulumtuesve të pavarur, prej të cilëve, pozita 1.2 (Një) hulumtues i pavarur për udhëheqje dhe menaxhim në arsim ishte pjesë e shqyrtimit nga ky komision.

Detyra e komisionit është të shqyrtojë dokumentacionin dhe të hartojë raportin profesional. Më hartimin e raportit përfundon puna dhe përgjegjësia e komisionit. Komisioni për zbatimin e procedurës së zgjedhjes së hulumtuesit të pavarur për udhëheqje dhe menaxhim në arsim, i emëruar më 27.11.2024, në mbledhjen e Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës, në përbërje: Prof. Ass. Dr. Blerta Perolli-Shehu (kryetar) UP, Prof. Ass. Dr. Fjolla Kacaniku (anëtare) UP, Prof. Ass. Dr. Iliriana Tahiraj, (anëtare), UP. Komisioni, pasi e ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e kandidatës së paraqitur në konkurs, i paraqet Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës vlerësimin profesional-shkencor për kandidatët e paraqitur për pozitën e hulumtuesit të pavarur për udhëheqje dhe menaxhim në arsim:

### **VLERËSIMI PROFESIONAL DHE SHKENCOR**

Duke u mbështetur në dokumentacionin dhe dosjet e dorëzuara nga kandidatët, komisioni vërteton se në konkursin e shpallur më datë 14.11.2024, në gazetën Epoka e Re dhe në Faqen Zyrtare të Institutit Pedagogjik të Kosovës, për pozitën e hulumtuesit të pavarur për udhëheqje

dhe menaxhim në arsim në Institutitutin Pedagogjik të Kosovës, ka konkurruar vetëm një (1) kandidate: Luljeta Shala, nr. protokollit 01/2024..

Komisioni, pasi e verifikoi dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatja, ka konstatuar se ajo i plotëson kushtet formale juridike për t'iu nënshtruar procedurave të përzgjedhjes për pozitën e hulumtueses për udhëheqje dhe menaxhim në arsim. Komisioni me kujdes e ka shqyrtuar dosjen e kandidates dhe, në bazë të kriterëve të shpallura në konkurs, me kujdes i ka shqyrtuar përvojën, edukimin, punimet e publikuara në revista të indeksuara, publikimet në revistën “Kërkime Pedagogjike” dhe aktivitetet shkencore duke përfshirë pjesëmarrjen në konferenca shkencore. Komisioni i ka paraqitur të dhënat biografike dhe bibliografike për kandidaten që ka aplikuar, sipas datës dhe nr. të protokollit:

1. **Luljeta Shala** u lind më 16.01.1979 në Prishtinë. Studimet themelore i mbaroi në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Edukimit dhe mori titullin Profesor i pedagogjisë në vitin 2003. Studimet e nivelit master i kreu në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, programi Master në Udhëheqje në arsim, në vitin 2017. Studimet e doktoratës i ka regjistruar si studente e rregullt në Universitetin e Evropës Juglindore, Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit, në programin studimor Menaxhimi dhe Udhëheqja në Arsim në vitin akademik 2023/2024. Kandidatja i ka përmbledhur publikimet shkencore duke i radhitur ato sipas formularëve për aktivitetin hulumtues, shkencor dhe profesional, sic është specifikuar në Rregulloren e IPK-së, 55/24, nr. 15, e datës 12.09.2024. Krahas listës së aktiviteteve hulumtuese, shkencore dhe profesionale (Formulari I) dhe aktiviteteve botuese në botimet monografike shkencore dhe dokumente tjera (Formulari II), kandidatja ka ofruar edhe dëshmi për secilin nga këto aktivitete. Po ashtu, kandidatja ka ofruar dëshmi për pjesëmarrje të rregullt në konferenca të ndryshme shkencore. Kandidatja ka përvojë pune 17 vjet si hulumtuese në IPK (që nga viti 2007) dhe gjatë kësaj kohe ka publikuar 17 punime në revistën “Kërkime Pedagogjike” si autore e vetme ose si bashkëautore. Ndërsa, para vitit 2007, kandidatja ka punuar si mësues dhe edukatore.

**Shënimet përmblledhëse për kandidatët e paraqitur për pozitën: Hulumtues i pavarur për udhëheqje dhe menaxhim në arsim,  
në bazë të konkursit nr. 69/02, datë 14.11.2024**

1.	Emri dhe mblemri	Biografia (CV)	Grada dhe thirrja shkencore	Moshë (datëlindja)	Përvoja në udhëheqje	Përvoja kërkimore - shkencore			Projekti për zhvillimin e veprimtarisë së IPK-së për periudhën 4-vjeçare	Njohja e gjuhës angleze	Dëshmi se kandidati nuk është i dënuar
						Publikimet shkencore: Artikuj në revista të indeksuara	Kumtesat në konferenca ndërkombëtare	Monografi, libra të botuar			
1	Luljeta Shala	PO	<b>Master</b> – Udhëheqje në arsim <b>Doktoratura</b> – Menaxhimi dhe udhëheqja në arsim	16.01.1979	7 vjet	10 punime	4 kumtesa	8	/	Nuk ka dëshmi për njohjen e gjuhës angleze	PO

Mbështetur në të dhënat e prezantuara nga kandidatja, të cilat janë paraqitur për pozitën e hulumtuesit të pavarur për udhëheqje në arsim në Institutin Pedagogjik të Kosovës, dhe duke iu referuar Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, nr. 04/L-135, të datës 11/02 maj 2013, nenit 48 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, dhe Rregullores nr. 55/24 të datës 12.09.2024, Komisioni për zbatimin e procedurës së përzgjedhjes së hulumtuesit të pavarur për udhëheqje në arsim, i emëruar më 27.11.2024, në mbledhjen e Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës, në përbërje: Prof. Ass. Dr. Blerta Perolli-Shehu (kryetar) UP, Prof. Ass. Dr. Fjolla Kacaniku (anëtare) UP, Prof. Ass. Dr. Iliriana Tahiraj, (anëtare) UP, ka përgatitur këtë raport për Këshillin Shkencor të Institutit.

Duke u mbështetur në rezultatet dhe të arriturat e punës profesionale dhe shkencore, përgatitjen adekuate për pozitën e kërkuar në konkurs, punimet shkencore të botuara në revistat shkencore relevante, pjesëmarrjen në aktivitete profesionale, konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, përvojën e punës, të kërkuara me konkurs, komisioni për zbatimin e procedurës së përzgjedhjes së hulumtuesit të pavarur për udhëheqje dhe menaxhim propozon që kandidati, **Luljeta Shala**, i plotëson kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta, të kërkuara në konkurs, për pozitën e hulumtuesit të pavarur për udhëheqje dhe menaxhim në Institutin Pedagogjik të Kosovës.

## PËRFUNDIM

Në bazë të Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, nr. 04/L-135, të datës 28.03.2013, 5, si dhe në bazë të si dhe në bazë të nenit 48 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, , dhe Rregullores nr. 55/24 të datës 12.09.2024.

Si dhe bazuar në të arriturat profesionale dhe shkencore, komisioni profesional-shkencor për zbatimin e procedurës së përzgjedhjes së hulumtuesit të pavarur për udhëheqje dhe menaxhim të Institutit Pedagogjik të Kosovës njëzëri i propozon Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës kandidatin **Luljeta Shala**, i cila i plotëson kushtet për hulumtuese të pavarur të Institutit Pedagogjik të Kosovës.

*Prishtinë, 10.12.2024*

### **Komisioni profesional-shkencor për zbatimin e procedurës së zgjedhjes së hulumtuesit të pavarur në IPK-së**

1. Prof. Ass. Dr. Blerta Perolli-Shehu, UP (kryetare)
2. Prof. Ass. Dr. Fjolla Kacaniku, UP (anëtare)
3. Prof. Ass. Dr. Iliriana Tahiraj, UP (anëtare)

